

AKT THEMELIMI
I SHOQERISE ME PERGJEGJESI TE KUFIZUAR
“ARBER 32 KOMPANI” SHPK

Neni 1: Emri dhe forma ligjore

Sot më datë 02.10.2020, une i nenshkruari:

1. **Haxhi ALIU**, lindur ne Durres, i datëlindjes 23.01.1989, madhor dhe me zotesi te plote per te vepruar, me numër identifikimi Karte identiteti I90123018W

themelojmë një shoqëri me përgjegjësi të kufizuar me emrin
“ARBER 32 KOMPANI” SHPK

Shoqeria rregullon veprimtarine e saj ne perputhje me Aktin e Themelimit, Statutin e saj,
me ligjin 9901 date 14.04.2008 “Per tregtaret dhe shoqerite tregtare”

Neni 2: Selia

Selia e shoqërisë do të jetë:

Maminas, Vlashaj, Zona Kadastrale 3796 , Godina me nr. Pasurie 347/16. Durres.

Shoqeria mund të hapë filiale, degë apo përfaqësi në të gjithë territorin shqiptar dhe jashte saj.

Neni 3: Objekti

Shoqëria do të ushtrojë veprimtarinë si më poshtë:

- Tregtim, import-eksport pajisje te ndryshme e makineri te renda, si dhe pjesëve të tyre të këmbimit .
- Ndërtimin dhe projektimin e objekteve të ndryshme, ekonomike, civile, industriale, turistike, bujqësore dhe ushtarake si banesa, komplekse turistike, zyra, pishina, zhvillimi i dekorit në mjediset urbane, turizëm, hoteleri etj.,
- Rikostruksione, punime bojatisje-hidroizolim, termoizolim-akustike-kundrazjarrit, mirëmbajtje objekteve te ndryshme.
- Prodhim dhe shitje materiale ndërtimi.

- Tregtim me shumicë dhe pakicë, import - eksport i mallrave të ndryshme industriale, lëndë të para për industrinë, tregtim makinerish dhe pajisje tekstili, pajisje hidrosanitare, elektrike, etj.
- Shoqëria sipas nevojave të aktivitetit ka të drejtën e ushtrimit të çdo aktiviteti të ligjshëm, të lejuar për formën e shoqërisë, e cila nuk ndalohej me ligj (sipas nenit 7 të Ligjit nr.9901, dt.14.04-08).

Neni 4: Kohëzgjatja

Kohëzgjatja e shoqërisë do të jetë pa afat.

Neni 5: Kapitali

Kapitali i shoqërisë është **100.000 (njqindmije) Leke**, i ndarë në 1 kuote.

Kontributi i ortakëve në kapitalin e shoqërisë është vlerësuar sipas të dhënave të mëposhtme:

Haxhi ALIU është zotëues i 1 kuote, me 100 % pjesëmarrje në kapitalin e shoqërisë, me vlerë 100.000 Leke.

Neni 6: Organet drejtuese të shoqërisë

Organet drejtuese të shoqërisë do të jenë:

(-) Asambleja e Përgjithshme.

(-) Administrator i shoqërisë do të jetë **Z. Haxhi ALIU**, për një periudhë 5 vjeçare me të drejtë riemërimi.

Neni 7: Viti ushtrimor

Viti ushtrimor fillon me 1 Janar dhe mbaron me 31 Dhjetor.

Neni 8: Dispozitat e fundit

Shoqëria respekton ligjin dhe statutin që është pjesë e pandarë e këtij akti.

Për çdo gjë tjetër, që nuk është shkruar shprehimisht në këtë statut, zbatohet legjislacioni në fuqi për shoqëritë tregtare, për QKR-në si dhe çdo ligj tjetër mbi veprimtarinë e shoqërive me përgjegjësi të kufizuar.

Emri dhe nënshkrimi i Ortakut të Shoqërisë

Haxhi ALIU